REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 906 - 907 - 909/20
Datë/Datum. 25.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT TEKNIK

Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues *Lindita AVDYLI – Exp. Teknik*	***Data e autorizimit të ekspertit*** **13.11.2020**	***Data e dorëzimit të raportit*** **25.11.2020**

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.11.2020, OE NSHT "Neramed & Genius Kosova"shpk – Gracanice, ka parashtruar ankesë me nr: 906/20, kundër propozimit per dhënie pas ri vlerësimit ne lot 3. OE "Interlab" – Prishtine, ankesën me nr 907/20, dhe OE "Liri Med" Prishtine, ankesën me nr. 909/20, kundër propozimit per anulim te lotit 2, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim emergjent me aparature dhe paisje laboratorike per testim molekular dhe serologjik per Covid 19", me nr. Prokurimi: 206-20-3665-1-1-5, iniciuar nga AK – Ministria e Shendetesise (MSH).

- Psh, me datën 06.10.2020, ka nxjerr vendimin me nr.535-607-614/20.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë emergjente te negociuar pa publikim te njoftimit, lloji i kontratës, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:
Lot 1 – 1,543,000.00€
Lot – 2 - 425,000.00 €
Lot – 3 - 512, 000.00 €

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE NSHT "Neramed" – Prishtine
Dispozitat e shkelura nga Ak, sipas OE ankues
Neni 1, 6, 7, 28, 59 dhe 60, te LPP-se
Deklarata Detale ne Ankese

Ne lidhje me tenderin: "Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19" dhe me nr te prokurimit: 206-20-3665-115, kemi pranuar Njoftimin per Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit, edhe pse kompania jone ka qene Operatori Ekonomik i Pergjegjshem me cmimin me te ulet konform kerkesave te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Me poshte mund te gjeni cdhe nje kronologji te shkurtcr, ku shihet se i kemi dorëzuar te gjitha dokumentat dhe njoftimct qe tregojne se jemi Operator Ekonomik i Pergjegjshcm.

Ne lidhje me tenderin: "Fumizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19" dhe me nr te prokurimit: 206-20-3665-115, kemi pranuar ftesen per Ofertim per tender te negociuar pa publikim te njoftimit per kontrate.

Ne me date, 28.07.2020 kemi dorezuar Oferten tone ne e-Prokurim dhe kemi dorezuar te gjitha dokumentat e kerkuara dhe poashtu edhe mostrat e produkteve.

Me daten 10.08.2020 kemi pranuar Kerkesen per Sqarimin e Tenderit, dhe menjehere me date 11.08.2020 kemi dorezuar gjitha sqarimet qe na eshte kerkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Dhe me date 17.08.2020, jemi njoftuar me nje Vendim te padrejte dhe ne kundershtim me ligjin e prokurimit publik te Republikes se Kosoves me arsyetimet e meposhtme: Arsyetimi 1 ngaAK:
Tek Artikulli 3.8 (Minicentrifug) nuk e ka ofruar katallogun ne oferten baze, por vetem me sqarime ku nuk e ka cekur modelin.

a) Me ligjin per prokurim publik eshte e cekur qartc se ne baze te nenit 72 mund te kërkohen sqarime shtese nga Operatori Ekonomik.
Ne katallogun e dorezuar mc daten 11.08.2020, keni pasur Modelin Meteor me 5 modelem u te gjitha ato modele kane plotesuar kerkesat e specifikacionit teknik te Dosjes se tenderit.
Edhe pse nuk kemi pranuar kerkese per sqarime se per cilin model kemi ofertuar, po ju bashkangjesim ne Kerkesen per Rishqyrtim edhe njehere katallogun me modelin **METEOR Meteor 10K dhe deklaraten se i permbushim te gjitha specifikimet teknike.**

Arsyetimi 2 nga AK:

Nuk ka ofruar Referencat ose Raportct e pranimit te furnizimeve, per vleren financiare Lot 3 = 512,000.00 €.

Nuk keni vepruar konform Ligjit per Prokurimin Publik, ku eshte dashur te kërkohen sqarime shtese pcr Rerefencat pasi qe eshte dorczuar Lista per Fumizime te ngjashme ne vlere me te madhe se Kerkesa e Autoritetit Kontraktucs e kerkuar ne Dosjen e Tenderit. Vlera e listes se furnizimeve te ngjashme eshte afcr 900,000.00€ apo afer 2 here me e madhe se Kerkesa e vete Autoritetit Kontraktues. Ne Kerkesen per Rishqyrtim gjeni te bashkangjitur Referencat dhe Raportet e Pranimit ne vlere prej 600,000.00€.

Lusim qe te rishqyrtoni Vendimin tuaj pasi qe eshte ne kundershtim me Ligjin per prokurim publik dhe po demtohet buxheti i Republikes se Kosoves per rreth 45,000.00€ per vetëm nje nenvizim te modelit te Minicentrifuges ku te gjitha modelet e ketij lloji e kane plotësuar kerkesen e Autoritetit kontraktues dhe eshte dashur te kerkohen sqarime, poashtu per Referenca ku dihet se vetem Autoritetin tuaj e kemi furnizuar per rreth 300,000.00€ dhe Lista e kontratave kalon shumen minimale te percaktuar nga Autoriteti juaj.

II

Kurse me date 26.08.2020 kemi pranuar Vendimin mbi refuzimin si te pabazuar (ne kerkese per rishqyrtim kemi ankuar per 2 pika) dhe ne njeren pike gjate leximit te vendimit na eshte aprovuar pika e Ankeses per Referenca.

Dhe na eshte paraqitur edhe pika qe nuk plotesojme tek Artkulli 3.9 temperaturen ku te njohesit e pajisjes dihet se ajo pike eshte devijim i vogel dhe ne kushte normale temperatura maximale qe perdorer eshte 134 C.

Ky vendim mbi refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim eshte i padrejte per arsye se jemi eleminuar per pika minore/ devijime te vogla ku poashtu OE i rekomanduar per kontrate tek pozicioni 3.1 nuk ploteson:

Eshte kerkuar:

To protect personel, product and environment; Overall dimensions 1685x840x1450 (usefull dimensions 1530x600x700);

Eshte ofruar:

To protect personel, product and environment; Overall dimensions 1500x750 (usefull dimensions 1350x600x660);

Pra, kerkojme nga Autoriteti juaj qe me miresi te APROVOJ te bazuar ANKESEN tone, dhe te kthej lenden ne Ri-Vlcresim dhe te na shpallc kompanine tone si OE i pergjegjshem.

OE "Interlab"shpk – Prishtine
Dispozitat e shkelura nga Ak, sipas OE ankues

Neni 1, 6, 7 dhe 59, te LPP-se.

Deklarata Detale ne Ankese

OE Interlab shpk si pale pjesemarrese dhe e paknaqur ne kete aktivitet te prokurimit publik, pas pranimit te vendimit te AK-se per anulim vërejmë qarte se kompania jone Interlab shpk edhe pse ka qene e pergjegjshme si ne anen administrative e poashtu edhe sipas kerkesave teknike nga ana e njesise kerkuese eshte eliminuar padrejtesisht. Pas pranimit te vendimit te OSHP-se me numer: 535-607-609-14/20 mendojme se ka mundur te rrjedh ndonje gabim teknik pasiqe ne vendimin e OSHP-se thuhet qarte se ne si OE kemi mjafte referenca per mbulimin e vleres: 1,543,000.00 sipas FDT. Ne si OE kemi ofruar liste te referencave ne vlere prej mbi 2,779,276.00 euro, nder to jane edhe projektet te cilat jane realizuar ne kohen e pandemise per te cilat ne perveq referencave te nenshkruara nga ana e tyre kemi ofruar edhe fletedergesa te bashkangjitura me faktura per te cilat dy nga to kane qene te pa nenshkruara. Kete liste te kontrata po jua bashkangjesim se bashku me ankese, dhe per te cilat referenca nese ka nevoj OSHP mund te i verifikoj nje nga nje !! Ne mendimin e ekspertit shqyrtues njera nga pretendimet ka qene se disa nga fakturat nuk jane te nenshkruara e keto faktura kane qene ne total vetem 2 te vleres totale: 93147.25 Euro, e per te cilat ne posedojme referenca dhe fletepranimet te nenshkruara nga Autoriteti Kontraktues. Faktura 75/20 me vlere prej: 63347.25 per te cilen ne kemi bashkangjitur fletedergesen dhe referencen te nenshkruar nga World Health Organization, faktura ne fjale nuk eshte e nenshkruar si shkak i situates se pandemise. Faktura 12/20 me vlere prej 29,800.00 euro e cila nuk eshte e nenshkruar si shkak i situates se pandemise, mirepo per te cilen ne kemi bashkangjitur fletepranimin nga komisioni pranues dhe per te cilen ne kemi deshmi te pagesave te taksave ne ATK. Edhe sikurse te mos merren parasysh keto dy faktura ne prapseprape e permbushim dhe e tejkalojme vleren e referencave ne FDT. 4/3 Duke vleresuar lart shume profesionalizimin e Organit Shqyrtues te Prokurimit Publik dhe duke marre parasysh gjendjen shume te veshtire te situates se krijuar nga Covid 19, besojme larte se vendi i Kosoves ka nevoj me shume se kurr per keto paisje ne menyre qe te behet testimi masiv i popullates se Kosoves e me kete duke parandaluar shume perhapjen e virusit dhe perfundimin me fatalitet te ketyre rasteve. Sipas vendimit te OSHP-se ne si OE i permbushim 100% te specifikimeve teknike minimale te detyrueshme ne Aneksin 1 te DT. Kerkojme nga Paneli qe lenda te kthehet ne rivlersim, dhe AK te na shpalle si fitues pasiqe jemi e vetmja kompani me oferten me te favorshme dhe te pergjegjshme si ne pjesen administrative e poashtu edhe ne pjesen e specifikimeve teknike. LISTA E KONTRATAVE INTERLAB SHPK (2017 – 2020)

- Listen e kontratabve e gjeni ne ANKESE.

OE "Liri Med" – Prishtine

Dispozitat e shkelura nga Ak, sipas OE ankues

Neni 1, 7, 59, 60, 62 te LPP-se si dhe neni 44.5 i RrUOPP-se.

Deklarata Detale ne Ankese

Të nderuar ne me datë: 22.10.2020 në platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit për Lot 1, 2 dhe 3. Fillimisht ju sqarojmë se ne në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit ne me dt.04.08.2020 kemi pranuar vendimin e AK-së për pezullimin e aktivitetit të prokurimit, pasi që është bërë ankesë nga ana e një OE të interesuar kundër njoftimit për kontratë. Në lidhje me këtë ankesë paneli shqyrtues me dt.06.10.2020 ka nxjerr vendimin nr.535-607-609/20, ku në dispozitivin e këtij vendimi është cekur se anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për Lotet 1, 2 dhe 3 në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit. Arsyetimi i AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ku si arsye e ka cekur se janëbazuar në vendimin e OSHP-së, është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se në vendimin e OSHP-së janë bërë disa gabime, sepse OSHP-ja e ka cekur se anulohet njoftimi për dhënie për të tri lotet, mirëpo gabimi i OSHP-së dhe njëkohësisht fakti se arsyeja e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit është e pa

bazuar qëndron këtu, sepse AK-ja e ka shumë të qartë se në këtë vendim në lidhje me Lotin 2 nuk ka pasur fare OE të rekomanduar për kontratë. AK-ja ka qenë në dijeni se për Lotin 2 nuk është bërë vlerësim i ofertave dhe nuk ka pasur njoftim mbi vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit për Lot 2, ndërsa tani nxjerrin vendim për anulim të aktivitetit edhe përkundër faktit se AK-ja nuk e ka bërë fare vlerësimin e ofertave për Lotin 2. Vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u bazuar në vendimin e OSHP-së është i pa bazuar sepse ky vendim është marrë duke mos e analizuar fare këtë aktivitet të prokurimit, pasi që për lotin 2 siç e cekëm më lartë nuk është rekomanduar për kontratë asnjë nga OE ofertues por ka qenë i pezulluar aktiviteti i prokurimit për lotin 2. Mirëpo OSHP-ja edhe pse ka qenë i pezulluar aktiviteti i prokurimit për Lot 2, me një vendim e ka vendosur edhe ankesën e OE të interesuar për Lot 2 dhe ankesat e OE tjerë ofertues për Lot 1 dhe 3, duke i cilësuar si të njëjta, pra të gjitha ankesat i ka cilësuar si ankesa kundër njoftimit për dhënie të kontratës. Andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur AK-ja më veprimin e saj që e ka bërë duke nxjerr vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u bazuar në vendimin e OSHP-së, ka treguar jo seriozitet në vlerësimin e tenderëve në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, pasi që ka nxjerr një vendim duke u bazuar në vendimin e OSHP-së i cili është krejtësisht i gabuar në lidhje me konstatimet për Lot 2. Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk qëndron për faktin se AK-ja nuk e ka bërë vlerësimin fare për Lot 2 ku ne kemi ofertuar, andaj është për tu habitur se si mund të anulohet aktiviteti i prokurimit duke u bazuar në vendimin e OSHP-së, e ku në atë vendim ceket se anulohet njoftimi për dhënie për lot 1, 2 dhe 3 përderisa AK-ja e din shumë mirë që aktiviteti i prokurimit për Lot 2 ka qenë i pezulluar. Andaj duke u bazuar në këtë fakt vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit është komplet i pa bazuar dhe gjithashtu edhe absurd. Gjithashtu nga vendimi i OSHP-së kuptohet se edhe OSHP-ja nuk i ka trajtuar në mënyrë të drejtë ankesën për Lot 2 ose ka rënë në lajthitje në lidhje me ankesën për këtë lot. Ne me dt. 28.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues, e ka cekur se nuk mundet ta shqyrtojë kërkesën tonë për rishqyrtim pasi që me vendim të OSHP-së është anuluar ky aktivitet i prokurimit. Ky arsyetim i AK-së për mos shqyrtimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe me këtë veprim të saj AK-ja nuk e ka respektuar nenin 108/A. Pasi që nuk është e ndaluar me asnjë dispozitë ligjore të bëhet ankesë kundër një vendimi që po na dëmton neve si kompani e përgjegjshme. Pra AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 108/A, duke mos e shqyrtuar kërkesën tonë për rishqyrtim, pasi që kërkesa për rishqyrtim dhe tani ankesa janë parashtruar më pretendimet plotësisht të bazuara, sepse Loti 2 i këtij aktiviteti të prokurimit nuk është vlerësuar fare nga ana e autoritetit kontraktues, andaj nuk mund të anulohet sepse nuk është bërë vlerësimi i ofertave. Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se vendimi i AK-së për mos shqyrtimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nuk qëndron dhe është i pa bazuar. Duke u bazuar në të gjitha sqarimet që i kemi cekur më lartë, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sepse asnjëra nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur, për shkak se ne jemi ofertues i përgjegjshëm. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Po ashtu ju si autoritet kontraktues nuk e keni pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Krejt në fund kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së që të korrigjojë vendimin Nr. 535- 607-609/20 për Lot 2 sepse shihet qartë që është bërë një ngatërrim nga ana e OSHP-së kur është shënuar se edhe ky aktivitet ka të bëjë me njoftim për dhënie të

kontratë, e nuk është sqaruar dhe si duket nuk është kuptuar që ky Lot ka të bëjë me ankesë kundër njoftimit për kontratë. Prandaj kërkojmë që të korrigjohet i njëjti vendim përkitazi me Lot 2 edhe pse këtë kërkesë është dashur ta bëjë vetë autoriteti kontraktues. Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM APROVOHET ankesa e OE "Liri-Med" si e bazuar,

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Një deklarate e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

2. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para publikimit të Njoftimit per dhenje të Kontratës].

3. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

. Deklarata nën Betim.

2. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës, kopje.

3. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës (origjinal ose kopje e noterizuar).

Përshtatshmëria profesionale

. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.

2. Regjistrimi ne regjistrin Fiskal

3. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove.

4. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se është i regjistraur ne AKPPM si qarkullues me shumicë i produkteve dhe pajisjeve medicinale (me validitet).

5. Kërkohet qe prodhuesi te jetë i certifikuar me ISO 13485

6. Kërkohet qe prodhuesi te jetë i certifikuar me CE 93/42.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. **Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje.**
2. **Certifikata e Numrit Fiskal – kopje.**
3. **Certifikata e TVSH-se – kopje**

Licenca nga AKPPM si qarkullues me shumice i produkteve dhe pajisjeve medicinale (me validitet) – Kopje.

4. **Kopje e Certifikates ISO 13485 për prodhuesin.**
5. **Kopje e certifikates CE 93/42.**

Kapaciteti teknik dhe professional

1. **Operatori ekonomik duhet të ofroj katalogun (broshuren) për pajisjet e ofruara.**
2. **Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se është i autorizuar nga prodhuesi.**
3. **Kërkohet qe OE të deklaroj per se do ta beje liferimin jo me vonë se 60 ditë nga marrja e porosisë.**
4. **Kërkohet qe OE të deklaroj se pajisjet e ofruara kane Garancion te përgjithshem 24 muaj pas instalimit**

dhe testimit (përveç dëmtimeve fizike).

5. Kërkohet qe OE të dëshmoj mbështetjen nga prodhuesi me pjesë rezervë të nevojshme për shtatë (7) vitet në vijim.

Kërkohet qe OE të ketë realizuar kontrata te ngjashme (pajisje mjekësore) brenda tri viteve te fundit, per vlerën minimum

Lot 1 = 1,543,000.00 €
Lot 2 = 425,000.00 €
Lot 3 = 512,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. **Katalogu (broshura) me përshkrimin e pajisjeve (aparaturave) dhe specifikimeve te ofruara.**
2. **Autorizimi nga prodhuesi (me te dhëna mbi prodhuesin: adresa, nr. tel, email, web faqja etj, për mundësi te verifikimit tek prodhuesi).**
3. **Deklaratë per afatin e liferimit jo me vonë se 60 ditë nga marrja e porosisë.**
4. **Deklarata e Garancionit te përgjithshem per pajisjet e ofruara 24 muaj pas instalimit dhe testimit (përveç dëmtimeve fizike).**
5. **Lista e pjesëve reserve nga prodhuesi për shtatë (7) vitet në vijim.**

Lista e kontratave per furnizime të ngjashme (pajisje mjekësore) nga operatori ekonomik ne tri vitet e fundit, bashkangjitur Referencat ose Raportet e pranimit te furnizimeve, për vlerën minimum:

Lot 1 = 1,543,000.00 €
Lot 2 = 425,000.00 €
Lot 3 = 512,000.00 €

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
AK – MSH per lot 1 shperblen me kontrate OE "Keis (Kosova Ex. Imp. Supply Pharmaceut) shpk , ne vlerën totale te negociuar 1,396,530 €

AK – MSH per lot 3, shpërblen me kontrate NTP "Eramed" ne vlere totale te ofertës se negociuar 479, 300€.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: OE NSHT "Neramed & Genius Kosova "ShPK – Gracanice, ka parashtruar ankesë, kundër propozimit për dhënie te kontratës. ne lot 3. OE "Interlab" – Prishtine, po ashtu kundër propozimit për dhënie ne lot 1, dhe OE "Liri Med" kundër anulimit te lotit lot 2.

Fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit, përkatësisht lot 1, 2 dhe 3, kane qene objekt shqyrtimi ne OSHP, dhe paneli shqyrtues ka nxjerr vendim me datën 06.10.2020, me nr.535-607-614/20, ku te tri lotët janë

anuluar. Konkretisht ne piken II, te diapozitivit është potencuar se AK/MSH, nëse ende ka interes për ketë aktivitet te prokurimit mund ta Ri tenderoi.

Parashtruesit e ankesave, me datën 26 dhe 27.10.2020, kanë parashtruar kërkesa për ri shqyrtim tek AK-MSH. Ndërsa AK, përmes njoftimeve te datës 28.10.2020, janë njoftuar se OSHP, me datën 06.10.2020, ka anuluar këto lote te këtij aktivitetit te prokurimit.

- Ne anën tjetër parashtruesit e ankesave sipas deklaratave ne ankese kontestojnë dhënën ne lot 1 dhe 3, si dhe anulimin e lotit 2.

Sipas shkresave te lendes se AK-se, e-prokurimi , rezulton qe AK nuk ka proceduar me ri vlerësim te ofertave, një gjë e tille është potencuar edhe përmes njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit te datës 22.10.2020.

- Prove: se bashku me raport gjeni njoftimin e datës 22.10.2020

Neni 44.11, i RrUOPP-se, shprehimisht potencon: *"Në qoftë se një procedurë e prokurimit është anuluar dhe AK ende dëshiron të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit përkatës, AK do të fillojë një procedurë të re të prokurimit pa ndryshuar numrin e prokurimit, por duke identifikuar atë me "Ri-tender"*. Pra AK, pas anulimit te aktiviteti te prokurimit me vendim te OSHP-se, nuk mund te ri vlerësoi oferta por duhet te inicioj procedure te re te prokurimit.

Paragrafi 5 i nenit 111, te LPP-se, potencon se *"Nëse OSHP konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP menjëherë do të (i) caktojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 113 dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t'i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë".*

Ne kemi pranuar autorizim per t'i trajtuar pretendimet ankimore, rrjedhimisht sqarojmë se pretendimet ankimore te OE NSHT "Neramed", shpk eksperti teknik sqaron se i njëjti OE ishte eliminuar ne kundërshtim me kërkesat e vena ne dosje te tenderit pasi qe i njëjti ka prezantuar katalogun përmes te cilit eshte i evidentuar artikulli 3.8 (Minicentrifug), rrjedhimisht mos nënvizimi i pozicionit nuk e bene ofertuesin te pa pergjegjeshem. Sa i përket pretendimit tjeter, arsyetimit te eleminimit lidhur me projektet e realizuara, edhe AK, pas kërkesës se pare per rishqyrtim e ka pranuar si te bazuar kete pretendim ankimor.

OE tjeter, i "Interlab" shpk, sqarojmë se sipas listes se prezantuar ne oferte nuk e mbulon kërkesën e AK-se, per projekte te ngjashme te realizuara (paisje mjekesore) pasi qe i njëjti ne listë ka prezantuar projekte te cilat nuk nderlidhen me kërkesën e AK-se, rrjedhimisht nuk e plotëson vlerën e kërkuar nga AK- MSH. Parashtruesi tjeter OE "Liri Med", konteston mosvleresimin e lotit 2. Poashtu thekson qe edhe paneli shqyrtues, ka potencuar se anulohet njoftimi per dhënie te kontratës ne lot 2, përderisa ankesa ka qene kundër njoftimit per kontrate ne te njëjtin lot. Eshte reale qe ankesa paraprake kundrejt te njëjtit lot ka qene kundër njoftimit per kontrate dhe nuk eshte vlerësuar.

8. MENDIMI I EKSPERTIT TEKNIK

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues – teknik konisderon se, meqë me vendimin paraprak jane anuluar lotet e kontestuara, mbetet qe paneli shqyrtues te vendos per veprimet e mëtutjeshme.

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shendetesise.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues:
- OE NTSH "Neramed & Genius Kosova"shpk – Gracanice
- "Interlab"Shpk – Prishtine
- "Liri Med" shpk – Prishtine.

Shovë

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Departamenti i Prokurimit/Department nabavke /Procurment Departmenta

Prishtinë

22.10.2020

Njoftim për Anulim te Aktivitetit te Prokurimit

Ne bazë te Vendimit te OSHP-së me Nr. 535-607-609-614/20 te datës 06.10.2020 **ANULOHET** aktiviteti i prokurimit **"Furnizim emergjent me aparaturë dhe pajisje laboratorike për testim molekular dhe serologjik për Covid 19"** - Lot 1, 2 dhe 3, me numër prokurimi 206-20-3665-1-1-5 dhe numër te brendshëm 206-20-39-115.

Me respekt,

Div. i Prokurimit ne MSh